

VENDIM

Nr. 184, datë 11.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 668, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 524, DATË 30.7.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 21, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 668, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, në rastet kur thirren në repart për nevoja shërbimi, ruajtjeje, gatishmërie, stërvitjeje ose fushimi, trajtohen me ushqim të gatuar, sipas normës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

2. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, kur nuk trajtohen me ushqim të gatuar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, si dhe kur duhet të trajtohen me ushqim, por nuk kanë infrastrukturën për gatim dhe servirje ushqimi, përfitojnë kompensim në vlerë leku, si më poshtë vijon:

a) Oficerët aktivë të Forcave të Armatosura 2 000 (dy mijë) lekë në muaj;

b) nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura 3 000 (tre mijë) lekë në muaj;

c) ushtarët aktivë të Forcave të Armatosura 4 000 (katër mijë) lekë në muaj;"

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Nuk trajtohen sipas pikës 2, të këtij vendimi, ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, të cilët trajtohen sipas vendimit nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atashëve ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake

ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuara në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë."

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA